

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KiiZ." SHPK

Sot, në Tiranë, më 09/04/2021 bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "KiiZ." SHPK

Unë ortaku i vetëm Mozak Xhelili, i biri i Viktorit, i datëlindjës 14/05/1983, lindur në Vergo dhe banues në Tiranë në adresën: ish fusha e avionit, pallatet IBN, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr. 035773576 dhe me numër personal I30514047T, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare "KiiZ." SHPK, e cila do ti nënshkruhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare "KiiZ." SHPK do të jetë në adresën: Rruga. Abedin Rexha, Pallati IBN, Kulla 4, Njesia Nr.7 Tirane.

Neni 3

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: Prodhim dhe tregti materiale ndertimi, duralumini dhe mobilerie. Aktivitet ndertimi, import-export materiale te ndryshme, investitor ne ndertim. Cdo aktivitet tjeter qe lidhet me aktivitetin kryesor.

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.000.000, kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelistët të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

DREJTAMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "KiiZ." SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Mozak Xhelili për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Shoqëria tregtare "KiiZ." SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "KiiZ." SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themeli u përpilua në 4 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkuar në të gjitha kopjet.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"KiiZ." SHPK

ORTAKU I VETËM

Mozak Xhelili

